- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
  - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					



---

<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Theksojmë se 'Specifikimet Teknike' i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.*

*Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

---

## *Specifikime Teknike*

### **Shpenzime mirembajtje sistem. financa, prokurimi, buxheti dhe e-ticket**

#### **Permbajtja**

1. Table of Contents	
1. QELLIMI I SHERBIMIT .....	38
2. FUSHA E ZBATIMIT TE SHERBIMIT .....	38
3. KERKESAT PER MIREMBAJTJEN E KOMPONENTEVE SOFTUER TE SISTEMIT TE ALBCONTROL .....	38
3.1. Sherbimet e kerkuara.....	38
3.2. Komponentet Software te implementuar.....	39
3.3. Kontrolli performances .....	39
3.4. Raportime.....	39
3.5. Nivelet e Raportimit te Sherbimit. ....	40
4. KERKESAT PER MIREMBAJTJEN E INFRASTRUKTURES HOSTUESE TE VIRTUALIZUAR TE SISTEMEVE FINANCIARE.....	40
4.1. Sherbimet e kerkuara.....	40
5. KOHA E PERGJIGJES PER SHERBIMET E OFRUARA .....	41
6. PERIUDHA.....	41
7. MIREMBAJTJA .....	41
7.1. Sherbimet e Mirembajtjes. ....	41
7.2. Sherbime te Mirembajtjes Parandaluese. ....	41
7.3. Sherbime Riparimi ne Vendodhje (Mjediset e Perfituesit te Sherbimit).....	41
7.4. Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.....	42
7.5. Pergjigja ndaj Alarmeve Madhore. ....	42
7.6. Veprimtarite e Diagnostikimit dhe Riparimit.....	42
8. KATEGORIZIMI I PROBLEMEVE DHE KOHA E PERGJIGJES .....	43
9. TABELA E ZERAVE .....	44
10. PRANIM I ISHERBIMIT .....	45

---

## 1. QELLIMI I SHERBIMIT

*Objekti kryesor i ketij sherbimi eshte vazhdueshmeria e Mirembajtjes se Sistemit duke perfshire te gjithe komponentet e tij software, me qellim permiresimin e performances, cilesise se sherbimit dhe vazhdimesise se punes per te gjitha sherbimet e ofruara nga ky sistem.*

Qellimi i ketij sherbimi eshte sigurimi i nje kontrate suporti dhe mirembajtjeje per sherbimet ne favor te Albcontrol, per funksionimin dhe perdorimin normal per Programet aplikative per Menaxhimin e Buxhetit dhe Shpenzimeve Financiare (Oracle E-Business Suite R12(12.2), Menaxhimin e Aseteve dhe Inventarit (Oracle E-Business Suite R12 (12.2), Administrimin e te Ardhurave (Oracle E-Business Suite R12 (12.2), produktin software per Prokurimet dhe Blerjet(Oracle E-Business Suite R12 (12.2) dhe software-in per Burimet Njerzore dhe Pagat (Oracle E- Business Suite R12 (12.2), qe ALBCONTROL ka ne perdorim.

## 2. FUSHA E ZBATIMIT TE SHERBIMIT

Fusha kryesore e zbatimit te ketij sherbimi eshte mirembajtja per Programet aplikative per MENAXHIMIN E BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE (Oracle E-Business Suite R12 (12.2), Menaxhimin e Aseteve dhe Inventarit (Oracle E-Business Suite R12 (12.2), per ADMINISTRIMIN E TE ARDHURAVE (Oracle E-Business Suite R12 (12.2), produktin software per Prokurimet dhe Blerjet (Oracle E-Business Suite R12 (12.2) dhe me software-in per Burimet Njerzore dhe Pagat (Oracle E-Business Suite R12 (12.2), qe ALBCONTROL ka ne perdorim ku perfshihen:

- a. Keshillim dhe konsulence teknike
- b. Monitorim te sistemit software
- c. Lokalizim dhe regullim te bug-eve te softuerit

## 3. KERKESAT PER MIREMBAJTJEN E KOMPONENTEVE SOFTUER TE SISTEMIT TE ALBCONTROL

Nje nga komponentet ne fushen e zbatimit te ketyre kerkesave per sherbime eshte mirembajtja sistemeve financiare te Albcontrol.

### 3.1. Sherbimet e kerkuara.

- a. Sherbimi Help-Desk 8 ore ne 5 dite te javes (asistence on-line dhe on-site per te gjitha komponentet softuer te permendur me siper);
- b. Raportimi i defekteve nga cdo vendndodhje dhe zgjidhja e tyre;
- c. Suporti i plote teknik sipas tabelës se kohës se pergjigjes/veprimit;
- d. Pershtatje e plote ne komunikim dhe nderfaqesim te infrastruktures ekzistuese

---

e. Diagnostikimi dhe identifikimi i detajuar i problemeve dhe keqfunksionimeve te komponenteve softeware-ike si dhe sugjerimi i masave qe duhen marre, duke i ofruar informacion te plote stafit teknik te Albcontrol.

### 3.2. Komponentet Software te implementuar.

- Sistemi i Menaxhimit te Aseteve, Inventarit dhe e-Ticket (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))
- Programet aplikative per automatizimin e administrimit te te ardhurave (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))
- Programet aplikative per Prokurimet dhe Blerjet (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))
- Programet aplikative per Burimet Njerezore dhe Pagat (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))
- Programet aplikative per Menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimeve financiare (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))

### 3.3. Kontrolli performances

Sherbimi do te kerroje monitorimin dhe kontrollin e te gjitha komponenteve softuer te percaktuar ne tabelen e sherbimeve. Kontrollin do te pasqyrojne te gjitha defektet dhe incidentet qe kane ndodhur ne komponentet tyre softuer. Kontrollin gjithashtu duhet te identifikojne veprimin korrigjues te ndermarre, kohen e riparimit, si dhe pikat e meposhtme:

- Kontrollin/testimin periodik te komponenteve software
- Kontrollin per kryerjen e veprimeve specifike ne rast zbulimi te problemeve
- Kontrole per kryejten e mirembajtjes proaktive
- Rekomandimet per nderhyrje/permiresime te mundshme

### 3.4. Raportime

Sherbimi qe do te ofrohet nga Operatori Ekonomik Ofertues do te perfshije monitorimin aktiv te sistemeve Software dhe perpilimin e raporteve periodike mujore te cilat do te japin nje pershkrim te pergjithshem te performances dhe gjendjes se sistemeve ne Albcontrol.

Ne raport do te paraqiten veprimet e ndermarra per korrigjimin e problemeve, koha e riparimit dhe detaje te tjera teknike. Per ndertimin e formulareve te raportimit Ofruesi i Sherbimit do te bashkepusoje me stafin teknik te Albcontrol per detaje te metejshme. Ofruesi i Sherbimit ka per detyre monitorimin e vazhdueshem te sistemeve dhe ne menyre specifike te propozoje:

- a. Nje plan vjetor te aprovuar per menyren e ofrimit te ketyre sherbimeve dhe per kontrollin e logeve te sistemeve qe disponojne te tilla.
- b. Nje plan tremujor per perditesime dhe ndryshime nese do te shfaqet e nevojshme gjate mirembajtjes se sistemeve per sistemin e monitorimit dhe te menaxhimit, ose ne rast te ndryshimeve te kerkuara te paraqese planin e

---

implementimit per keto funksione duke perfshire edhe ndryshimet ne softueret e menaxhuara.

- c. Raportimin e problemeve te identifikuara.
- d. Propozimin e masave organizativo-teknike qe duhen marre me qellim minimizimin e perseritjes se tyre.

### **3.5. Nivelet e Raportimit te Sherbimit.**

Ofruesi i Sherbimit se bashku me Albcontrol duhet te organizoje takime permbledhese mujore dhe tre mujore nepermjet te cilave do te shqyrtohet:

- Monitorimi i problemeve te pazgjidhura.
- Update-imi i progresit te mirembajtjes.

## **4. KERKESAT PER MIREMBAJTJEN E INFRASTRUKTURES HOSTUESE TE VIRTUALIZUAR TE SISTEMEVE FINANCIARE**

Operatori ekonomik duhet te realizoje dhe mirembajtjen e infrastiktures hostuese te virtualizuar te sistemeve finaciare

### **4.1. Sherbimet e kerkuara.**

- a) Kontrolle te pergjithshme periodike te statusit te infrastruktures hostuese virtuale Oracle Linux KVM te sistemeve finaciare
- b) Kontroll mujor i statusit te sherbimeve te infrastruktures hostuese virtuale Linux KVM
- c) Kontroll i pergjithshem i nodeve te virtualizuara me Oracle Linux KVM
- d) Kontroll i pergjithshem i haperisave te virtualizuara (storage) te nodeve te virtualizuara me Oracle Linux KVM
- e) Kontroll dhe verifikim i statusit te makinave virtuale dhe utilizimit te resurseve
- f) Shtimi i makinave te reja virtuale ne infrastrukturen virtuale Oracle Linux KVM sipas kerkesave te Albcontrol
- g) Modifikimi i resurseve te makinave virtuale ne infrastrukturen virtuale Oracle Linux KVM sipas kerkesave te Albcontrol
- h) Raportimi i defekteve te platformes hostuese te virtulizuar te sistemeve finaciare zgjidhja e tyre
- i) Suporti teknik per platformen hostuese te virtulizuar te sistemeve finaciare, sipas tabelës se kohes se pergjigjes/veprimit;

Diagnostikimi dhe identifikimi i detajuar i problemeve dhe keqfunksionimeve te te platformes hostuese te virtulizuar te sistemeve finaciare si dhe sugjerimi i masave qe duhen marre, duke i ofruar informacion te plote stafit teknik te Albcontrol.



## 5. KOHA E PERGJIGJES PER SHERBIMET E OFRUARA

Koha e pergjigjes/veprimit per zgjidhjen e problemeve mbeshtetur ne pershkrimin e efektit percaktohet ne **Tabela e Kohes se Pergjigjes per Sherbimet e Ofruara**.

## 6. PERIUDHA

Ne tabelen e meposhteme jepet periudha e sherbimeve te Operatorit Ekonomik

No.	Pershkrimi I Sherbimit	Periudha
1	Sherbime Suporti dhe mirembajtje per Albcontrol	12 Muaj

Afati kohor i shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë minimalisht 1 vit ose ( 12 muaj) , në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

## 7. MIREMBAJTJA

Te gjitha konfigurimet qe do te behen gjate kohes se suportit do te dokumentohen dhe duhet te

dorezohen nga kontraktuesi ne format elektronik dhe ne hard copy.

Akresi per perdorim te sistemit gjate kohes se suportit duhet te kerkohet nga kontraktori tek perfituesi me forme zyrtare.

### 7.1. Sherbimet e Mirembajtjes.

Kompania duhet te ofroje sherbime te mirembajtjes sipas niveleve te sherbimit dhe metodikes se pershkruar me poshte.

### 7.2. Sherbime te Mirembajtjes Parandaluese.

Operatori ekonomik duhet te ndermarre, ne menyre periodike nje here ne muaj, Sherbime te Mirembajtjes Parandaluese per te gjitha software-t e listuara ne tabelen e listes se fumizimeve. Sherbimet Parandaluese, jane sherbime proaktive te cilat do te mundesojne dedektimin ne kohe te problematikave, dhe do mundesojne ndermarijen ne kohe te hapave rekuperuese, per te mos patur nderprerje te sherbimit. Te gjitha sherbimet e mirembajtjes parandaluese do te kryhen prane perfituesit te sherbimit, pervec rasteve kur perfituesi i sherbimit percakton nje vendndodhje te re per kryeijen e ketyre sherbimeve.

### 7.3. Sherbime Riparimi ne Vendodhje (Mjediset e Perfituesit te Sherbimit).

Operatori ekonomik duhet te jete i disponueshem gjate intervaleve kohor nga e Hena ne te Premte, 8x5, per te ofruar Sherbime te Riparimit ne pergjigje te “Alarmeve Madhore” te raportuara nga personeli i autorizuar i perfituesit te sherbimit ("Emergency On-Call Hours"). Per kete qellim, me termin Alarm Madhor do te kuptohet parashtrimi i kerkeses per Sherbime Riparimi te ndermarra ne rast te keqfunksionimit te software-ve te mbuluara, qe i pengon ato te operojne ne perputhje me Specifikimet dhe shkaktojne nderpreje te menjehershme e te konsiderueshme te sistemit dhe qe, nuk mund te shmangeshin me ane te nderhyrjeve dhe riparimeve minore te kryera nga stafi teknik i perfituesit te sherbimit dhe

---

te rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet qe nuk i perkasin “Alarimeve Madhore”, duhet te adresohen nen Sherbime te Mirembajtjes Parandaluese.

#### **7.4. Njoftimi dhe Njohja e Alarimeve Madhore.**

Perfituesi i sherbimit do te njoftoje operatorin ekonomik me telefon, poste elektronike ose duke sinjalizuar nepermjet nje nderfaqeje web te vene ne dispozicion, dhe do te prese te kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjate “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet te kontaktoje perfituesin e sherbimit dhe te konfirmojne marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i perfituesit te sherbimit. Ne momentin e njohjes se thirrjes nga operatori ekonomik, do te vere ne dispozicion informacione te paracaktuara ne Procedurat e Troubleshooting nga operatori ekonomik, dhe do ta asistojte ate gjate diagnostikimit te problemit te raportuar. Do te koeperoje me kerkesen e operatorit ekonomik per ta ndihmuar ate, ne percaktimin e shkakut te problemit te raportuar dhe ne percaktimin e nevojës per vizite ne vendndodhje per te kryer Sherbimet e Riparimit.

#### **7.5. Pergjigja ndaj Alarimeve Madhore.**

Nese operatori ekonomik nuk mund te percaktojte nepermjet Informacionit te mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atehere ai duhet te dergojte nje Teknik Sherbimi prane perfituesit te sherbimit brenda intervalit kohor prej dy (2) oresh nga momenti i marrjes se njoftimit per Alarm Madhor. Me te mberritur, tekniku i kompanise do te mbeshtetet me asistencen nga perfituesi i sherbimit dhe do ti jepet liri veprimi ne mjediset dhe sistemet e mbuluara, per te filluar menjehere procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

#### **7.6. Veprimtarite e Diagnostikimit dhe Riparimit.**

Me te mberritur ne vendndodhje, tekniku i sherbimit duhet te filloje procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Keto veprimtari duhet te vazhdojne deri sa (a) Alarmi madhor te jete korrektuar ose te jete “zgjidhur ne menyre te terthorte”, (b) tekniku te jete zevendesuar nga nje person tjeter, (c) Operatori ekonomik te percaktojte se problemi i raportuar nuk eshte shkaktuar nga ndonje keqfunksionim i Sistemeve te mbuluara ose (d) Operatori ekonomik arrin ne konkluzion qe diagnostikimi ose korrektimi i metejshem mund te shtyhet deri ne mberritjen e pjeseve te kembimit.

Tekniket e sherbimit te kompanise duhet te jene te trajnuar, certifikuar dhe autorizuar per te ndervepruar ne menyre direkte me prodhuesit.

Kompania duhet te krijojte/diskutoje me perfituesin e sherbimit nje axhende periodike kontrollesh si me poshte:

#### **Mujore**

- a. Testim / kontroll i kompletuar i komponenteve softuerik se klientit
- b. Kontroll i detajuar i log-eve software
- c. Rishikim i te dhenave mbi performance e komponenteve softuerik
- d. Rekomandime per upgrade te mundshme software

## 8. KATEGORIZIMI I PROBLEMEVE DHE KOHA E PERGJIGJES

Ne tabelen e meposhtme percaktohet kategorizimi i seriozitetit te problemeve dhe koha e pergjigjes per zgjidhjen e tyre gjate periudhes se mirembajtjes.

Serioziteti 1 (Kritik/ i Larte)	Serioziteti 2 (I Mesem)	Serioziteti 3 (I Ulet)
<b>Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare</b>		
Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare te medha per perdoruesit ose rrezikon shume aktivitetin ekonomik te perdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare te konsiderushme per perdoruesit ose rrezikon konsiderueshem aktivitetin ekonomik te perdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare minimale per perdoruesit ose rrezikon ne menyre minimal aktivitetin ekonomik te perdoruesve
<b>Pezullimi i punes</b>		
Mos funksionimi i aplikacionit pengon perdoruesit te realizojne pjesen me te madhe te punes se tyre.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon perdoruesit te realizojne disa pjese te vogla te punes se tyre, por ata jane ne gjendje te realizojne pjesen tjeter. Mund te perfshije gjithashtu pyetje dhe pergjigje per information.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon perdoruesit te realizojne nje pjese te vogel te punes se tyre, por ata jane ne gjendje te realizojne pjesen tjeter
<b>Numri i perdoruesve te ndikuar</b>		
Mos funksionimi i aplikacionit ndikon nje numer shume te madh te perdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon nje numer shume te vogel te perdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon ne 1 (nje) ose 2 (dy) perdorues
<b>Zgjidhje alternative e perkohshme [Kjo ka peshen me te madhe te karakteristikave te Seriozitetit 1 dhe 2]</b>		
Nuk ka nje menyre alternative te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund te realizohet ne nje menyre tjeter)	Mund te kete ose jo nje menyre alternative te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.	Potencialisht ekziston nje menyre alternative e perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.
<b>Koha e pergjigjes</b>		
Brenda nje ore	Brenda 8 (tete) oreve ose ditin tjeter te punes.	Brenda 8 (tete) oreve ose ditin tjeter te punes.
<b>Koha e zgjidhjes</b>		

Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 ore të vazhdueshme pas kontaktit të pare.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 20 diteve të vazhdueshme të punes.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 45 dite kalendarike.
--	---	--

Gjate periudhes të mirembajtjes operatori ekonomik fitues do të duhet të realizojë implementimin e modulit software për realizimin e kërkesave nga stafi për leje vjetore dhe aprovimin e tyre nga stafi menaxherial, në mënyrë elektronike.

Moduli software për marrjen e lejes vjetore në mënyrë elektronike duhet të jetë i integruar me Programet aplikative ekzistuese për Burimet Njerzore dhe Pagat.

Moduli software duhet t'i regjistrojë të dhënat për kërkesat për leje vjetore dhe aprovimin e tyre në bazën e të dhënave ekzistuese të Programeve aplikative për Burimet Njerzore dhe Pagat.

Moduli software duhet të mundësojë që leja vjetore për stafin, të jetë jo më pak se 4(kater)jave dhe (28 dite kalendarike), për të gjithë stafin brenda 1(nje) viti.

Moduli software duhet të mundësojë që leja minimale vjetore e kërkuar nga stafi, të jetë jo më pak se një javë kalendarike (7 dite).

Moduli software duhet të mundësojë që punëmarresi që nuk ka kryer një vit të plote pune, të ketë një përlogaritje në raport me kohezgjatjen e mardhenieve të punës. Ky raport duhet të jetë 2.33 dite në 1(nje) muaj.

Moduli software duhet të mundësojë regjistrimin e kërkesave për leje vjetore të stafit që ka më shumë 3(tre) muaj pune.

Moduli software duhet të mundësojë për përlogaritjen e diteve të lejes të vlefshme për stafin në bazë të vjetërsisë në punë.

Moduli software duhet të mundësojë për aprovimi e lejes vjetore sipas hirearkisë.

Moduli software duhet të mundësojë që pas aprovimit të lejes të vihet në dijeni departamenti i Finances.

Moduli software duhet të mundësojë që mos ketë mbivendosje të kërkesave të lejes vjetore për punonjës të të njëjtit pozicion pune.

## 9. TABELA E ZERAVE

Në tabelën e mëposhtme jepet lista e komponenteve objekt i shërbimeve nga Operatori Ekonomik.

No.	Pershkrimi i shërbimit	Periudha
1	Shërbime suporti dhe mirembajtje për Albcontrol, Keshillim, Monitorim, Raportim, për zërat e mëposhtëm:	12 muaj
1.1	Sistemi i Menaxhimit të Aseteve, Inventarit dhe e-Ticket	12 muaj

	(Oracle E-Business Suite R12 (12.2))	
1.2	Programet aplikative per automatizimin e administrimit te te ardhurave (Oracle E- Business Suite R12 (12.2))	12 muaj
1.3	Programet Aplikative per Prokurimet dhe Blerjet (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))	12 muaj
1.4	Programet aplikative per Burimet Njerzore dhe Pagat (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))	12 muaj
1.5	Programet aplikative per Menaxhimin e Buxhetit dhe Shpenzimeve Financiare (Oracle E-Business Suite R12 (12.2))	12 muaj

#### 10. PRANIM I ISHERBIMIT

Dokumentacioni qe verteton realizimin e sherbimit te mirembajtjes (si: Raporte sherbimi, proces verbal sherbimi dhe faturimi) do te dorezohet nga Ofruesi i sherbimit prane Albcontrol sipas periudhes dhe kohes qe do te negociohet ndermjet paleve, e cila do te jete pjese e kontrates. Ky proces verbal mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga të tre anëtarët e saj.

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: “Shpenzime mirëmbajtje sistem financa, prokurimi, buxheti, e-ticket”**

**Afatet e ekzekutimit:** 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës

---

## Shtojca 7

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shpenzime mirembajtje sistem. financa, prokurimi, buxheti dhe e-ticket”,

Detyrat: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Albcontrol sha

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**



---

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** kriteret e mesiperme janë vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: i ndryshuar citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 10 000 000 leke pa tvsh (40% e fondit limit) ose

2.2.2 Bilancet e viteve 2020, 2021 dhe 2022. miratuar nga organet perkatese shteterore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese kontrata ku te kete realizuar sherbime te ngjashme, në një vlerë jo më vogël sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare (ISO):

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.
- **ISO 27001-2017**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

**Argumentim:** Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij. Sistemi i menaxhimit te sigurise se informacionit siguron qe operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përqsaje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me focus tek siguria.

---

2.3.3 Operatori ekonomik, duhet të ketë marrëdhënie partneriteti aktive me prodhuesin Oracle. Kjo duhet të dëshmohet nëpërmjet certifikates së partneritetit origjinal ose kopjes të noterizuar të certifikates, të lëshuar nga prodhuesi Oracle.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të LPP: *Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*Meqënese sistemet e menaxhimit financiar të Albcontrol sha janë produkte të gatshme Oracle E-Business Suite R12, është e domosdoshme që operatori fitues të ketë marrëdhënie partneriteti të dokumentuar me prodhuesin Oracle, për të kryer shërbimet që kërkohen në kvitë projekt, duke minimizuar në këtë mënyre rreziqet në lidhje mbi kohën dhe cilësinë e dhenies së shërbimit të mirembajtjes*

2.3.4. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë të projektit, të ketë në ekipin e realizimit të projektit të pakten 8 (tete) personel staf me certifikime të kombinuara. Stafit i certifikuar i projektit duhet të jenë të diplomuar në një prej degeve në vijim: Inxhinieri Elektronike, ose Inxhinieri Informatike, ose Teknologji Informacioni, ose Informatike, ose Informatike Matematike, ose Inxhinieri Matematike dhe Informatike, ose Informatike Ekonomike ose Telekomunikacion, ose Shkenca Kompjuterike.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë të gjithë stafin dhe personelin tekniko-profesional, i cili do të angazhohet në shërbimet e kerkuara. Në përberje të stafit Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht stafin e mëposhtem:

**a)** Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar nga Oracle për suportin (mbeshtetjen) e sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E-Business Suite ose ekuivalent.

**Argumentim:** *Duke qenë se gjatë zbatimit të kontratës mund të jetë e nevojshme të behen ndryshime në sistemet e menaxhimit financiar të Albcontrol, është e domosdoshme që operatori ekonomik fitues të ketë punonjës të certifikuar nga prodhuesi për suportin (mbeshtetjen) e sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E-Business Suite, për të garantuar shërbime të suksesshme gjatë zbatimit të kontratës.*

**b)** Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar nga Oracle për implementimin e sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E-Business Suite R12, për secilin nga modulet dhe rrespektivisht të modulit të Librit të Madh (General Ledger), të Pagueshmeve (Payables), të Arketueshmeve (Receivables), të Zinxhirit të Furnizimeve (Supply Chain) ose ekuivalent.

**Argumentim:** *Duke qenë se gjatë zbatimit të kontratës mund të jetë e nevojshme të behen ndryshime në aspektin e implementimeve funksionale të sistemeve të menaxhimit financiar të Albcontrol, është e domosdoshme që operatori ekonomik fitues të ketë punonjës të certifikuar nga prodhuesi për implementimin e sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E-Business Suite R12, për secilin nga modulet dhe rrespektivisht të modulit të Librit të Madh (General Ledger), të Pagueshmeve (Payables), të Arketueshmeve (Receivables), të Zinxhirit të Furnizimeve (Supply Chain), për të garantuar shërbime të suksesshme gjatë zbatimit të kontratës*

---

c) Te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar nga Oracle per zhvillim software-i ne sistemin të menaxhimit të bazave të të dhënave relacionale Oracle, Oracle PL/SQL dhe zhvillimi Oracle Forms ose ekuivalent.

**Argumentim:** Duke qene se gjate zbatimit te kontrates mund te jete e nevojshme te behen ndryshime ne aspektin e programimeve ne nivel te paketave, procedurave, funksioanve apo formave te sistemeve te menaxhimit financiar te Albcontrol, eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar nga prodhuesi Oracle per zhvillim software-i ne sistemin të menaxhimit të bazave të të dhënave relacionale Oracle, Oracle PL/SQL dhe zhvillimi Oracle Forms, per te garantuar sherbime te suksesshme gjate zbatimit te kontrates.

d) Te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar nga Oracle per implementimin e bazave të të dhënave Oracle ose ekuivalent.

**Argumentim:** Duke qene se gjate zbatimit te kontrates mund te jete e nevojshme te behen ndryshime ne aspektin e implementimit te bazes se te dhenave te sistemeve te menaxhimit financiar te Albcontrol, eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik fitues te kete punonjës te certifikuar nga Oracle per implementimin e bazave të të dhënave Oracle, per te garantuar sherbime te suksesshme gjate zbatimit te kontrates.

e) Te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar nga Oracle per implementimin e serverit te aplikimeve Oracle WebLogic Server ose ekuivalent.

